



Policia arreston tre persona në Pejë, sekuestrohet kokainë, një armë dhe mbi 10 mijë euro

KRONIKA | April 28, 2022 - 18:35

SHPËRINDAJE:



Policia e Kosovës gjatë ditës së sotme rreth orës 10:50, ka realizuar një kontroll në një shtëpi banimi në Pejë, në të cilën dyshohej se jetonte personi i dyshuar B.L.

Sipas njoftimit të PK-së thuhet se gjatë realizimit të operacioni të kontrollit nga antidroga e Policisë në shtëpinë e të dyshuarit të lartcekur, në cilësi të provave materiale ka gjetur dhe sekuestruar substancë të dyshuar narkotike në formë pluhuri ngjyrë të bardhë e dyshuar për Kokainë, e mbështjellë në 163 qese të vogla të tejdukshme, të cilat pasi janë peshuar ka rezultuar se pesha e tyre është rreth 55.1 gram.

“Policia ka njoftuar se qeset ishin të gatshme për shitje, dhe ishin të fshehura në dy shishe plastike njëra me mbishkrimin “Cink” dhe tjetra “Orbit White”. Po ashtu janë sekuestruar 10,670 euro, dy telefona mobil Iphone; njëri Iphone 13 Pro Max dhe tjetri Iphone 8”, thuhet në njoftim, raporton Zëri.info.

Sipas njoftimit të PK-së, thuhet se po ashtu janë bastisur edhe dy shtëpi tjera banimi që i dyshuari ka shfrytëzuar kohë pas kohe për veprimtarinë e shitjes dhe fshehjes së substancave narkotikeve.

“Personi i dyshuar i lartcekur me iniciale është arrestuar dhe pas intervistimit me urdhër të prokurorisë për krime të rënda në Pejë, i caktohet masa e ndalimit prej 48 orësh, për procedura të mëtejme.


Në një tjetër rast, sot rreth orës 14:00, është realizuar një operacion të suksesshëm në Prishtinë të koduar me emrin “Porosia”, ku janë arrestuar në flagrancë dy persona të dyshuar duke kryer shitblerjen e një sasive të substancës së dyshuar narkotike, si kokainë”, thuhet në njoftimin e PK-së.

Në vazhden e realizimit të këtij operacioni në shtëpinë e të dyshuarit në Stanovc të Vushtrisë është kryer një bastisje/kontroll dhe si prova materiale janë gjetur rreth 200 gram substancë e dyshuar narkotike-kokainë, një pushkë e gjatë dhe dy dokumente të një shteti të huaj me identitet të të dyshuarit.

Policia e Kosovës me njësitet kompetente të saj mbetet e përkushtuar në parandalimin dhe luftimin e të gjitha veprave kriminale, përdërisa luftë e pa kompromis po zhvillon dhe do të zhvilloj ndaj abuzuesve dhe kontarbanduesve me substanca narkotike./Zëri



Të rekomanduara



Rrokulliset vetura e Policisë në rrugën...

April 27, 2022



Arrestohet një 21-vjeçar në Kaçanik, ishte i dënuar me 10 ditë burgim për vjedhje të pyjeve

April 27, 2022

Njësia Speciale vendoset në pikën kufitare në Bërnjak

KRONIKA | April 26, 2022

Bastiset një punëtori për servisim veturash në veri

KRONIKA | April 26, 2022

Pamje të veturës së Policisë së Kosovës, që u sulmua me armë sot në veri [foto]

KRONIKA | April 26, 2022

Aktakuzë për fajde ndaj dy personave në Prishtinë

KRONIKA | April 26, 2022


Arrestohen tre persona, të dyshuar për vjedhje në Spitalin e Gjilanit

KRONIKA | April 26, 2022


Sulmohet seksualisht një e mitur në Prizren

KRONIKA | April 26, 2022

Më të lexuarat



Rrokulliset vetura e Policisë në rrugën Mitrovicë - Prishtinë, lëndohen tre policë



Viktima dhe të plagosurit në Klinë janë vëllezër, vrasja ndodhi pas një iftari familjar



Apeli konfirmon aktakuzën ndaj Milaim Zekës për incizim fshehurazi të së dëmtuarës



Arrestohen katër personat që sulmuan patrullën e Policisë në Istog



Rrihen mes vete zyrtarët e Pallatit të Drejtësisë



Aksident i rëndë në autostradën “Ibrahim Rugova”, rrokulliset vetura